

KONGRESI I MANASTIRIT – KONGRESI I BASHKIMIT TË SHQIPTARËVE

Dr. Stefan **PINGULI***

Kongresi i Manastirit përfaqëson një nga ngjarjet më të rëndësishme atdhetare të Kombit tonë të shekullit 20, me objekt unifikimin dhe standardizimin e përpjekjeve të të shkruarit shqip dhe një provë e pa matshme, atdhe dashurie për bashkimin kombëtar. Kongresi I ABC-së ishte një urë lidhëse bashkimi kombëtar nga lidhja e Prizrenit deri tek mëvetësia e Kombit. Atdhetarët të udhëhequr nga Rilindësit vajtën në ditën e madhe të Kongresit, nën parullën “gjuha është shprehje e unifikimit të Kombit” si dhe “qëllimet e shenjta kërkojnë vënien e interesave Kombëtare mbi ato vetjake”.

Patriotët si Hasan Tasimi, Pashko Vaso, Babdud Karbunara, Jani Vreto, Konstandin Kristoforidhi, Petro Nini Luarasi etj, bënë përpjekje të mëdha për prodhimin e ABC-së dhe kultivimin e saj në popull, duke sakrifikuar veten dhe familjet e tyre për këtë qëllim të shenjtë. Petro Nini Luarasi ka qenë një atdhetar i shquar, përhapës i palodhur i gjuhës Shqipe në rrethin e Korçës. Përpjekjet e patriotëve në shërbim të gjuhës shqipe iu kundërvu fuqishëm shteti turk dhe kleri greko-serb.

Mbështetur në përpjekjet atdhetare dhe dëshirës popullore për të qenë një komb një etni, u thirr tubimi I dijetarëve Shqiptarë me 14-22 nëntor në Manastir për përcaktimin e alfabetit të gjuhës Shqipe në Shqipëri. Patriotët propozuan variante të ndryshme alfabeti, ku mbizotëronte mendimi për të pasur një alfabet me shkronja latine, në krye të këtij aktiviteti ishte shoqëria e mirënjohur Bashkimi “me qendër në Manastir. Shoqëria Bashkimi u bë nismëtarja e thirrjes së kongresit të parë të përgjithshëm për njehsimin e alfabetit në Shqipëri. Ky alfabet i njësuar do të ishte fillimi i letërsisë mbarë shqiptare. Delegatët erdhën nga e gjithë Shqipëria dhe nga të gjitha komunitetet shqiptare të Rumanisë, Italisë, Greqisë, Turqisë, Egjiptit, Amerikës etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, si një nga organizatorët kryesorë të Kongresit dhe redaktor i dy revistave që botoheshin në Selanik, “Liria dhe Dituria”. Sekretare e Kongresit u zgjodh Pareshqevi Qiriazi, mësuese e shkollës së vashave në Korçë.

Kongresi u përfaqësua nga 150 të ftuar dhe 50 delegatë, 32 me të drejtë vote dhe 18 pa të drejtë vote, të gjithë atdhetarë dhe dijetarë të kulturave të ndryshme, me dëshirë të zjarrtë për të zgjidhur hallet e vendit, veçanërisht të gjuhës. Këta dijetarë patën vendosmërinë dhe thjeshtësinë të sakrifikonin opinionet e tyre intelektuale për njehsimin e gjuhës shqipe. Kumtesa e priftit katolik Gjergj Fishta nga Shkodra ishte

sintezë e mendimit të përgjithshëm atdhetar që gjuha Shqipe të mos shkruhej me shkronja arabe ose greke por me shkronja latine.

**Akademia e Shkencave “Rrënjët Tona”, Studiues i gjuhësisë në fushat albanologjike*

Përpyjekjet e këtij dijetari e pozicionuan si kryetar organizativ të punës së kongresit i shoqëruar nga 11 anëtarë. Nga kongresi u përzgjedhën dy alfabetet, ai i shoqërisë Bashkimi dhe ai i Stambollit. Me kalimin e kohës si alfabet i lehtë për tu përdorur dhe shtypur fitoi të drejtën alfabeti latin me 36 shkronja, të cilin e përdorim dhe në ditët tona.

Vendosmëria për të kthyer sytë nga perëndimi, ishte haptas një shpallje kulturore e pavarësisë, gjë që nuk kaloi pa u vënë re nga qeveria turke dhe kleri serbo-grek. Një nga rilindësit më aktivë, Dom Ndre Mjeda i thuri vargjet më të bukura të gjuhës shqipe në atë kohë.

Përmbi za që lshon bylbyli, gjuha Shqipe m’ shungullon, përmbi ere që nep zymbyli, pa da zemrën ma ngushllon, geqe e toske malësi jallia, janë një komb me da zduron, fund e maje një është Shqipnija, e një gjuhë të gjithë na bashkon.

Në kushtet e Kongresit, atdhetarizmi pati jo vetëm format e tij intelektuale e kulturore por dhe ato tregtare, ku me fonde minimale u mbështet kongresi që nga shpenzimet organizative të përgjithshme e deri tek ndërtimi i një shtypshkronje të nevojshme për punët e ditës dhe me tej. Klubi i Manastirit u caktua si qendra për krijimin e një federate të klubeve shqiptare në Shqipëri dhe në kurbet.

Punimet e kongresit përveç pathosit intelektual për organizimin e një gjuhe unike shqipe, me karakteristika perëndimore, provokuan dhe marrëdhënie etiko-politike të cilat kulmuan në organizimin e kombit për arritjen e mëvetësisë, ku si qendër kishte përpyjekjet për gjuhën. Shpërthimi i shqiptarizmit i kaloi të gjitha parashikimet e armiqve të gjuhës shqipe. Në këtë kohë dolën në dritë rreth 90 gazeta dhe revista në gjuhën shqipe, që botoheshin në Shqipëri dhe në kolonitë shqiptare jashtë vendit. Shoqëritë shqiptare të Selanikut, Shkupit dhe Manastirit u shprehën në mbrojtje të alfabetit shqip. U vendos gjithashtu të mbahej një kongres tjetër në Manastir pas dy vjetësh, për të forcuar infrastrukturën e hapjes së shkollave dhe përgatitjen e kuadrit mësues për gjuhën. Nën frymën atdhetare të Kongresit të Manastirit u projektuan dhe ndërtuan një sërë shkollash si shkolla normale e Elbasanit në 1909 me drejtor Luigj Gurakuqin që do të përgatiste pionier të arsimit shqip. Shkolla të ngjashme u hapen në Korçë, Vlorë, Berat etj.. Reagimet antishqiptare në lidhje me gjuhën shqipe nuk munguan jo vetëm nga qeveria turke dhe kleri greko – sllav, por dhe nga konservatorët brenda vendit. Xhon

turqit me kryetarin e tyre Ferit Pashën, të frikësuar nga shpërthimi i shpejtë i arsimit shqip, reaguan ashpër duke ndaluar shoqëritë, shkollat dhe botimet në shqip. Në mbarë vendin u mbyllën shkolla dhe u internuan drejtuesit si ajo e Vlorës me drejtorin Loni Naci, Gjirokastrë me pionierin e arsimit shqip Koto Hoxhën, Krocë me Pandeli Sotirin si themelues të së parës shkollë.

Vendimi për unifikimin e alfabetit kaloi në vështirësi të mëdha pasi atdhetarët ABC-ista i parakaluan interesat vetjake në funksion të interesit të madh të kombit. Klubi Bashkimi ishte iniciatori dhe nxitësi më i vëmendshëm i këtij unifikimi, me priftin e kulturuar Gjergj Fishta i cili deklaroi në hapje të seancës plenare “s’kam ardhur për të mbrojtur asnjë alfabet, por të mbroj alfabetin e përbashkët”. Me themelimin e alfabetit të manastirit shqiptarët treguan se ishin popull i civilizuar, i cili filloi të standardizojë letërsinë mbarë shqiptare.

Kongresi i Manastirit nuk e përqendroi vëmendjen vetëm në problemin e zgjidhjes së alfabetit të gjuhës, por dhe në çështje të rëndësishme politike. U vendos që të shpallej si klub qendror ai i “bashkimit” të Manastirit, i cili jo vetëm mundësoi alfabetin e ri por zbatoi në praktikë duke i njohur gjithë botës aksiomën e famshme shqiptare “një komb, një gjuhë, një ABC”. Rëndësia historike e Kongresit të ABC-së nuk është sfumuar aspak nga organizimet dhe kongreset e mëvonshme, opinionet politike të kohëve apo lufta e pandërprerë e fqinjëve greko-sllave kundër gjuhës dhe të drejtës historike.

Rendësi të veçantë ka dalja në skenën e historisë të kombit të kokave më elitare dhe te kulturuar të rilindjes sonë kombëtare, si Mithat Frashëri, Gjergj Fishta, Imzot Kaçorri, Dom Ndre Mjeda, Parashqevi Qiriazi, Feim Bej Zavalani, Bajo Topalli, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, etj. Njehsimi i ABC-ve është pema e parë e kongresit, por ka dhe një pemë tjetër më të madhe dhe më të bukur, ajo e bashkimit të shqiptarëve rreth idealit kombëtar. Parë nën realizimin e kongresit, frymës atdhetare dhe mendjeve të ndritura që rrezatuan sa kulturë aq edhe atdhedashuri, brezit të sotëm i shtrohen disa detyra. Ky brez është i mbarsur me atavizma të kohëve të vjetra, shprehur me forma moderne dhe pretendime anti atdhetare të manifestuara në të gjitha institucionet e jetës së vendit. Problemet shfaqen:

Së pari, në faktin e mos unifikimit përfundimtar dhe përpunimit shkencor të gjuhëve rajonale si pasuri e paçmuar e kombit tonë. Nën presionin e shkencave gjuhësore dhe politikave nacionaliste të komshinjeve tanë xheloz janë përkrahur qëndrime antishkencore për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe aftësisë etnike të saj. Ky veprim shtrembëron kulturimin e brezit të ri me metoda antishkencore dhe kontradiktore.

Së dyti, paaftësia shkencore dhe politike për të shprehur të vërtetat historike dhe inferioriteti i paparë i institucioneve të mbështetura nga politika pragmatiste errësojnë këto të vërteta historike të reja dhe të vjetra. Të vërtetat historike duhen mbrojtur me kurajo shkencore dhe atdhetare nëpërmjet një infrastrukture të mirë trajtuar nga institucione shkencore si Akademia e Shkencave e cila duhet të jetë më shumë atdhetare se sa politikë zbatuese. Mbi të gjitha duhet shtuar vëmendja në tekstet shkollore me të cilat farkëtojmë atdhetarë ose antiatdhetarë. Riorganizimi i institutit polivalent mbarë kombëtar me të gjitha disiplinat shkencore nën drejtimin e Akademisë së Shkencave si në parlament shkencor dhe i barasvlershëm në vendim marrje teknike me parlamentin politik do të ishte mundësia e vetme që kemi për të ecur në rrugën e zhvillimit. Gjithashtu riorganizimi i institutit albanologjik si domosdoshmëri për të përpunuar si duhet “lëndën e parë” historike dhe gjuhësore në ingranazhet e makinerisë së saj shkencore do të nxirrte një produkt interesant dhe të nevojshëm për të gjitha kancelaritë shkencore të Evropës, produkt që po e presin me padurim.

Thirrja e zonjës Merkel para gazetarëve se “ua kemi borxh historinë shqiptarëve” është një kampanë alarmi për të gjithë në shqiptarët në përgjithësi dhe Ballkanit në veçanti.

